



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:190147

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186069

P.nr.212/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurve Y. S. dhe A. R., për shkak të veprës penale secili veç e veç "Deklarimi i rremë" nga neni 384 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2918/24, të datës 02.07.2024, në seancën e hapur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 19.09.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Besart Mustafa dhe të pandehurve, me datë 20.09.2024 mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit;

1. Y. S., nga i ati A. dhe e ëma N. e gjinisë G., i lindur më ... në fshatin R. - Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer autobusi, në kompaninë "D." T., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. A. R., nga i ati A. dhe e ëma N. e gjinisë Sh., i lindur më ... në fshatin D. - Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer dhe menaxher i firmës "B. R.", i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

I. Me datë 09.06.2024, rreth orës 13:33, në Stacionin Policor në P., të pandehurit Y. S. dhe A. R., kanë deklaruar se me datë 06.06.2024, rreth orës 07:30, kishin qenë në minibusin me targa ..., i cili ishte përfshirë në aksident trafiku në rreth rrotullimin e rrugëve "... N..." - "S." dhe "M. P.", i evidentuar me numër të rastit ..., ku nga ai aksident trafiku dy të pandehurit kanë paraqitur raporte mjekësore që sipas tyre janë lënduar në aksidentin e lartcekur, me ç 'rast të njëjtit kanë deklaruar rrejtshëm pasi që në bazë të kamerave të qytetit të vendosura në rreth rrotullim, është

vërtetuar se dy të dyshuarit nuk kanë qenë fare në minibusin i cili ishte përfshirë në aksident trafiku.

- me këtë të pandehurit secili veç e veç kanë kryer veprën penale “Deklarimi i rremë” nga neni 384 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës ligjore të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe të neneve 242, 364 dhe 449 të KPP-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

Me Dënim me Gjobë dhe Dënim me Kusht

I. Ashtu që u shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej pesëqind (500) Euro, të cilën të pandehurit secili veç e veç detyrohen ta paguajnë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë dhe

II. DËNIM ME KUSHT, ashtu që secilit veç e veç u cakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të pandehurit nuk kryejnë vepër tjetër penale.

III. Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën brenda afatit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t’u zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë, do t’u llogaritet një (1) ditë burgim.

IV. DETYROHEN të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale secili veç e veç të paguaj: për paushallin gjyqësor shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumë prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.2918/24, të datës 02.07.2024, kundër të pandehurve Y. S. dhe A. R., për shkak të veprës penale secili veç e veç “Deklarimi i rremë” nga neni 384 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.09.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe pasi bindet se të pandehurit e kuptojnë aktakuzën, të njëjtëve në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së u ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë – të pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen apo të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar secili veç e veç deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen si dhe gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë, duke shprehur keqardhje dhe premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime të tilla apo

kryejnë vepra tjera penale, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, nga gjykata kërkuan një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se të pandehurit kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga të njëjtit, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e tyre, përveç kësaj, pranimi i fajit është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore të KPP-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurve, marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurve të ndërmarra në kuadër të dashjes së tyre, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Deklarimi i rremë” nga neni 384 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, të njëjtit i shpalli fajtor dhe u shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga të pandehurit, keqardhjen e shprehur për veprimet e tyre, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj duke i vlerësuar këto rrethana, gjyqtari i vetëm gjykues vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr. 212/24, Datë 20.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.